



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog
Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komitetit për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

26	Procesverbal
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	12.05.2020, në ora 10:00
Mbledhjen e kryesoi:	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lart për Punë Profesionale
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Zenel Shatri, Besa Ferati, Haki Podrimaj, Elidon Ahmeti, Ardit Metaj dhe Ardita Idrizaj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Agim Ademaj, Edona Bujupi-Loxha, Osmon Sadikaj, Hajrush Shoshi, Enver Rugova, Mujë Osmanaj, Hysni Maxharraj, Lulzim Blakaj, Drin Sadikaj, Ardon Arifaj, Fjolle Berisha.
Rendi i ditës:	
<ol style="list-style-type: none">1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2019,3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020.4. Marrja e vendimit për Bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi z. Qaush Balaj, përshëndeti të pranishmit, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje. Në mbrojtje të infektimit nga pandemia dhe respektimit të masave ndaj virusit Covid 19, Sall që jemi tani është dezinfektuar, anëtarët e komitetit si dhe të pranishmit tjera janë pajisur me maska, doreza dhe dezinfektues në tavolina.</p> <p>Hapë punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje. Pasi e kemi Drejtorin e Shëndetësisë këtu prezent propozoj që të na njoftoj pak me gjendjen aktuale në komunën tonë në Istog me Covid 19,</p> <p>Kush është që kjo pik të hy në rend dite, si njoftim me gjendjen aktuale në komunën e Istogut me Covid 19.</p> <p>Kryesuesi - hedh në miratim këtë propozim: Njoftimi mbi gjendjen aktuale me Covid 19 në komunën e Istogut.</p> <p>Miratohet një zëri.</p>	

Hedh në miratim rendin e ditës	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri rendi i ditës, me këtë propozim nga Kryesuesi.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 1.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi - Fton Drejtorin e Shëndetësisë që të bëj një njoftim rreth gjendjes me Covid 19 në komunën e Istogut z. Mujë Osmanaj</p> <p>Mujë Osmanaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, Njofton të gjithë të pranishmit për gjendjen aktuale me Covid 19 në Komunën e Istogut, po ashtu Lutë të gjithë që të bëjnë durim dhe disa ditë deri në përfundim të pandemisë mos të dalin ti respektojnë masat, të kenë kujdes.</p> <p>Zenel Shatri - përshëndet të gjithë të pranishmit, me takon edhe mua si mjek Infektolog të flas pak, situata me Covid 19 është duke u menaxhuar shkëlqyeshëm. Lutë drejtorin e Shëndetësisë që të insiston të stafi i QKMF - Istog që të mbajnë masat mbrojtëse, sepse ata janë njerëzit e parë me kontaktin dhe duhet të jenë gjithnjë të mbrojtur.</p> <p>Ajshe Metaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, nuk ka pasur shumë raste tek ne në komunën tonë. I falënderoj mjeket që kanë qenë në vijën e parë të stafit, ju lus të mbroheni sa të mundeni.</p> <p>Mujë Osmanaj - thatë që nuk ka shumë raste dëshira jon kish qenë mos me pas as një raste të ruhem dhe mos të dalim sidomos pa masa mbrojtëse, ta ruajmë njëri tjetrin.</p> <p>Eliot Kukiqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, Falënderoje drejtorin e shëndetësisë për punën e deri tanishme.</p> <p>Kryesuesi - a ka dikush tjetër diçka. Pasi që diskutime tjera nuk ka vazhdojmë me piken tjetër.</p>	
Vendimet:	
Miratohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar, pa vërejtje.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Shqyrtimi i pikës 2.	
Diskutimet:	
<p>Kryesuesi, vazhdojmë më pikën tjetër të rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni.</p> <p>Kryesuesi - a ka dikush tjetër diçka.</p>	

Pasi që diskutime nuk pat hedh në miratim.

Vendimet:

Pasi që diskutime tjera nuk ka Komitetit vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të kalohet leuvendit te komunës për njoftim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Afati për zbatim:

Shqyrtimi i pikës 3.

Diskutimet:

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2019, raportin e keni pasur me material dhe keni pasur mundësi ta analizoni.

Osmon Sadikaj ZKF -- përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit Financiar për vitin 2019.

Elior Kukiqi -- të investimet kapitalet, drejtorat që nuk i kanë shpenzuar kapitalet le të ndëshkohen, komuna ka pësuar nga kjo nuk ka marr grandin e performances për shkak se nuk janë harxhuar mjetet e vitit paraprak.

Ajshe Metaj -- pse janë bërë kaq pak shpenzime kapitale ?

Osmon Sadikaj -- Eliot dhe Ajshe e keni pyetjen e njëjte e keni tabelën dhe mund ti shihni çdo shpenzim që është bërë. Drejtorit e kanë buxhetin e alokuar , dhe këto pyetja tia drejtoni drejtorave të drejtorive.

Ajshe Metaj -- a merr dikush përgjegjësi pse komuna e ka performancën jo të mirë.

Edona Bujupi Loxha, drejtoresh e Administrates - përshëndet të gjithë të pranishmit, ne me performanc jemi në vendin e tret por grandin nuk kemi mundur ta fitojm për shkak të 1.6% të mos përmbushjes së buxhetit për vitin 2019.

Kryesuesi - Pasi që diskutime tjera nuk ka atëherë kalojmë në pikën tjetër.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja kalon: Raportit Financiar për vitin 2019, dhe të njëjtin ia kalohet KK-së për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës Shqyrtimi i Raportit Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020

Osmon Sadikaj - prezanton dhe sqaron, Raportin Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020 .

Eliot Kukiqi - shpenzime ka pasur shumë pakë
Osmon Sadikaj - vetëm 20 mijë euro janë shpenzuar.

Zenel Shatri - duke e pasur parasysh gjendjen aktuale ky raport është i kënaqshëm.

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka, kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës
Nga anëtarët e KPF-së miratohet unanim,

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF njëzëri rekomandon: Shqyrtimi i Raportit Financiar për tre mujorin e parë të vitit 2020, si dhe i njëjti i kalohet KK-së për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Diskutimet:

Kryesuesi, po vazhdojmë me pikën e katërt e rendit të ditës Marrja e vendimit për Bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020.

Hysni Maxharraj - bënë prezantimin dhe sqarimin për Bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020.

Zenel Shatri - sqarona investimet në vim, trotuaret kubëzimi, lagja Hakaj, shkolla Orroberd.

Ajshe Metaj - mjetet e bartura janë shfrytëzuar për ndonjë borxhe, apo për ndonjë projekt tjetër.

Hysni Maxharri - Drejtorat e drejtorive i kanë dhënë këto projekte siç po i shihni këtu.

Eliot Kukiqi - këto projekte a janë të tenderuara.

Hysni Maxharraj - ne duhet ta dërgojmë këtë në ministri për miratim.

Kryesuesi i Kuvendit - ju mund të propozoni edhe projekte të reja ta ndryshoni këtë tabelë keni të drejt.

Hajrush Shoshi - propozon që 10 mijë euro nga Shërbimet publike te i qesim në Arsim për subvencione.

Zenel Shatri - propozoj që këto 10 mijë euro të shkojnë për trotuarin Tomoc - Gurrakoc. Nesë ka para të mjaftueshme në arsim këto 10 mijë euro të shkojnë për trotuarin, por nëse nuk ka para të mjaftueshme në arsim le të mbesin aty.

Ajshe Metaj - Propozon që këto 10 mijë euro të mbeten në Arsim.

Osmon Sadikaj - për arsim ka mjete të mjaftueshme dhe për subvencione ka pare janë të hyrat vetanake dhe ka mjete aty.

Kryesuesi pasi që diskutime tjera nuk ka po e hedhe në votim Bartjen me propozimin e Zenelit kush është për :

Me 6 vota për dhe 1 votë kundër u miratuar nga anëtarët e KPF-së Bartja e mjeteve financiare nga vitet 2018, 2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020, dhe si e tillë i rekomandohet ti kalohet KK.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF me shumicë votash rekomandon: Marrja e vendimit për Bartjen e mjeteve financiare nga vitet 2018,2019 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2020, dhe të njëjtin ia kalohet KK për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Diskutime tjera:

Kryesuesi, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë.

Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj : 12:10

